



**RAPORTI VJETOR**  
**PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË**  
**RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR**  
**PËR VITIN 2021**

Në bazë të nenin 22 paragrafi 2, neni 30 paragrafi 1 alineja 6, neni 32 dhe neni 65 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (Gazeta zyrtare e RMV, nr.24/21 dhe 174/21), Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti, ndërsa Këshillim për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e miratoj:

**RAPORTIN VJETOR**  
**PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR**  
**JUGPERËNDIMOR 2021-2026**  
**PËR VITIN 2021**

Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e përfshin periudhën nga janar- dhjetor viti 2021.

**REZIME**

Programi për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor është dokument bazik afatmesëm, i cili bazën juridike e ka në Ligjin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor (nenet 13,14,15), është përgatitur me qëllim që të zvogëlohen dallimet mes rajoneve planore, si edhe në vet rajonin, dhe të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm përmes shfrytëzimit të gjithë potencialeve në tërësi që e ka në dispozicion.

Operacionalizimi i Programit në nivel vjetor bëhet përmes Planit Aksionar, ku realizimi i tij është bazë për realizimin e qëllimeve dhe prioritetëve të përcaktuara në Programin për zhvillim të rajonit planor, gjegjësisht në aspektin ekonomik, infrastrukturor, zhvillimi rural, turizmi dhe kultura, si edhe arsimit edhe çështjet sociale dhe aspektet e tjera të zhvillimit në RPJP

Në Planin Aksionar për vitin 2021 janë planifikuar 73 aktivitete projektuese të cilat duhet të realizoheni nga ana Qendrës për zhvillim, komunat dhe ndërmarrjet publike komunale në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor. Nga ato, janë realizuar 52 aktivitete projektuese gjatë vitit 2021, gjegjësisht përqindja e realizimit është 70%.

Aktivitetet e projektit në kuadër të Biznes Qendrës janë realizuar në tërësi në afatin e paraparë. Gjithashtu janë kryer të gjithë aktivitetet në kuadër të projektit për investime “Rekonstrukcioni dhe vendosja e pajisjeve të qendrës moderne për terapi fizikale në spitalin Shën. Erazmo” në Ohër. Është përkthyer Programi për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026 në gjuhën shqipe. Qendra për zhvillim të RPJP fitoj shpërblimin për “Përfshirjen aktive të gjithë palëve të interesuara në procesin e planifikimit dhe implementimit të politikave në nivel rajonal” e cila u nda nga Ministria për vetëqeverisje lokale. Shpërblimi u shfrytëzua për trajnim dhe fuqizimin e aftësive të të punësuarve në Qendrën për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për transparencë përmes përmirësimit të sistemit të komunikimit në rrjetet sociale. Të gjitha këto aktivitete u financuan përmes projektit “Zhvillim i qëndrueshëm rajonal dhe inkluziv – faza I” me mjete nga Ministria për vetëqeverisje lokale dhe konfederata e Zvicrës.

Me mjetet nga Programi për subvencionimet kapitale në bujqësi për zhvillimin e rajoneve planore u ndërtua rrugë deri tek tokat bujqësore në Komunën e Vevçanit. Komunat kanë më shumë aktivitetet për ndërtim dhe rekonstruimin e infrastrukturës rrugore dhe komunale. Një pjesë e ndërmarrjeve publike komunale u furnizuan me pajisje komunale, kontejner dhe kosha për mbeturina.

Qendra realizoj projekte për efikasitet energjetik në objektet publike të komunave, me çka u përgatiten raporte dhe dokumentacione teknik me masa të efikasitetit energjetik.

Fatkeqësisht, një numër i konsiderueshëm të aktiviteteve të projektit të cilat ishin paraparë në kuadër të projekteve rajonale të cilat duhet të financoheshin përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal për vitin

2021 nuk u realizuan. Përkatësisht, Qendra në bashkëpunim me komunat përgatiti dy projekt aplikacione dhe i dorëzoi në afatit e përcaktuar ligjor deri në datën 15.12.2020. Në ndërkohë u miratua Ligji i ri për zhvillim të barabartë rajonal i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2021. Me ligjin e ri u vendosën programe të reja me çka u shkatërrua buxheti për rajonet planore, BZHR bashkë me MVL miratuan Program të ri dy vjeçarë për ZHBR për vitin 2021 dhe në mënyrë indikativë edhe për vitin 2022.

Prej Qendrave për zhvillim u kërkua që ti tërheqin aplikacionet dhe të dorëzojnë të reja në pajtueshmëri me Programin dy vjeçar për ZHBR në fillim të muajit gusht të vitit 2021.

Pasonte ndryshimi i Ligjit për ZHBR në shtator të vitit 2021 dhe përsëri procesi u bllokua. Marrëveshjet për realizimin e projekteve rajonale u nënshkruan me Byronë për zhvillim rajonal në 22.12.2021. Për shkak të ndryshimeve në Ligjin për ZHBR komunat marrin pjesë me mjete financiare për realizimin e projektit dhe kusht për publikimin e furnizimit publik është pagesa e këtyre mjeteve në llogari të Qendrës për zhvillim. Për këto arsye të cekura, të gjitha këto aktivitete përbëjnë 30% të aktiviteteve të planifikuara në Planin aksionar për vitin 2021 dhe të njëjtat ngelen për ti realizuar gjatë vitit 2022.

Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor është i përberë prej pjesës narrative dhe pjesës tabelore.

## I. PJESA NARRATIVE E RAPORTIT VJETOR

### 1. Lista e projekteve dhe aktiviteteve të realizuara

Kjo pjesë përmban listën e projekteve dhe aktiviteteve të realizuara në kuadër të çdo mase individuale, në pajtueshmëri me qëllimet strategjike dhe prioritet të përcaktuara në Programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Pra, për çdo projekt dhe aktivitet të realizuar shënohen: titulli i plot, periudha e saktë për realizimit, shuma e mjeteve të realizuara dhe shfrytëzuesi.

**Qëllimi strategjik 1 – Avancimi i ekonomisë dhe paritetin gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive krahasimore të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji të reja, njohuri dhe inovacion, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësi dhe zhvillim rural.**

#### Prioriteti 1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale

Masa 1.1.1- Nxitja e shpirtit sipërmarrës tek të rinjtë e posaçërisht tek gratë përmes trajnimeve dhe mbështetjes TIK dhe start-up bizneseve të reja

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.2 - Krijimi i një rrjeti informativ për zhvillim të inovacioneve në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.3 - Nxitja e unioneve dhe formimi i klasterave

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.4 - Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM

- Vepriktaria si zyrë rajonale kontaktuese i FIZHT/Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit / janar – shtator 2021 / 46.286 denarë/ Biznes sektori

- Mbështetje teknike dhe informimi i biznes sektorit për konkurse aktive / Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit/ janar – shtator 2021 / 46.286 denarë/ Biznes sektori

- Programi i vauçerave për ndërtimin e kapaciteteve të bizës sektorit/ Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit / janar – shtator 2021 / 266.567 denarë/ Biznes sektori

- Publikimi i listave për burime të mundshme financiare nga Qeveria dhe burime të tjera të biznes sektorit / Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit / janar – shtator 2021 / 46.286 denarë/ Biznes sektori

Masa 1.1.5 - Brendimi i produkteve dhe shërbimeve që janë të njohura për rajonin.

- Nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 1.2 Fuqizimi dhe modernizimi i sektorit të NVM-ve

Masa 1.2.1 - Nxitja e iniciativave për ndryshime strukturore tek sektori i NVM në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.2 - Nxitja e specializimit të mençur për zhvillimin ekonomik të rajonit

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.3 - Ruajtja e zejeve tradicionale dhe zhvillimi i bizneseve në zona rurale

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.4 Nxitja e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet subjekteve brenda vendit dhe jashtë

-Trajnim për fuqizimin e aftësive të të punësuarave në Qendrën për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për transparencë përmes përmirësimit të sistemit të komunikimit përmes rrjeteve sociale/ Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv/ shtator 2021/ 73.850 denarë/ të punësuarit e Qendrës për zhvillim të RPJP

- Përkthimi i Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026 në gjuhën shqipe/ Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv/ qershor 2021/ 73.850 denar/ palët e interesuara nga rajoni planor Jugperëndimor

Masa 1.2.5. - Nxitja e sipërmarrjes tek gratë

- Nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 1.3 Rritja e investimeve në rajon

Masa 1.3.1 Mapimi i potencialeve investuese në rajon

- Azhurnimi dhe publikimi i të dhënave për institucione dhe ndërmarrjet nga RPJP/ Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit/ janar-shtator 2021/46.286 denarë/ Biznes sektori

-Azhurnimi dhe publikimi i bazave të të dhënave për lokacione greenfield dhe browfield / Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit/ janar -shtator 2021/ 46.286 denarë/ biznes sektori

-Përgatitja e Regjistrit për sipërmarrësit, kompanitë dhe bujqit /Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit/ janar -shtator 2021/ 46.286 denarë/ biznes sektori

Masa 1.3.2 Nxitja e takimeve tek bashkësia e biznesit me investitorët potencial

Promovimi i Biznes qendrës në rrjetet sociale, publikime të rregullta në FB me informacione të cilat janë me rëndësi për kompanitë / Biznes qendra për mbështetje dhe shërbime të Biznes sektorit/ janar -shtator 2021/ 46.286 denarë/ biznes sektori

Masa 1.3.3 Organizimi i manifestimeve për promovimin e biznes sektorin

- Nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës

Masa 1.4.1- Ndërtimi dhe rekonstruktimi i rrjetit rrugor në rajon

- Rekonstruksioni i rrugës Zodishte- Pelvec (Komuna e Vevçanit)/ Ndërtimi i rrugës deri tek tokat bujqësore në RPJP / gusht-nëntor 2021/ 1.400.943 denarë/ bujqit në Komunën e Vevçanit

- Rekonstruksioni i rrugës deri në f.Podgorc (Komuna e Strugës)/ korrik-gushtë 2021/ 9.586.325 denarë /qytetarët e komunës së Strugës

- Rekonstruksioni i rrugës Jane Sandanski Ohër/ Programi për ndërtimin e rrugicave dhe rrugëve në Komunën e Ohrit/ prill-tetor 2021/ 13.533.886 denarë / qytetarët dhe vizitorët në Komunën e Ohrit

- Rekonstruksioni i rrugicave lokale KALANOJ 1, BEBEKOJ KOSHARI, POPAGJINI-KUKOJ, MUXHEJ DRENJE dhe PLLUSHOKOJ në Komunën e Vevçanit / Programi për ZHBR – zhvillimi i fshatrave / qershor-dhjetor 2021/ 2.115.670 denarë/ qytetarët e Komunës së Vevçanit

- Rekonstruksioni i rrugicave lokale RADINI 1, MLAKA-VETERNIK, DASKALOJ-OBIKOLNICA, dhe PUPINI-QEZHOJ në Komunën e Vevçanit / Programi për ZHBR – zona me zhvillim dhe nevoja specifike/ qershor-dhjetor 2021/ 1.517.890 denarë/ qytetarët e Komunës së Vevçanit

- Ndërtimi i rrugëve në f.Brest dhe f.Qereshnevo/ Programi për ZHBR- zona me zhvillim dhe nevoja specifike/ qershor-dhjetor 2021/ 5.247.169 denarë /qytetarët e Komunës së Makedonski Brod

- Ndërtimi i rrugëve në vendbanimin Duvedol dhe Greshnica-Makedonski Brod /Programi për ZHBR – zhvillimi i fshatrave/ maj-nëntor 2021/ 5.000.000 denarë /qytetarët e Komunës së Makedonski Brod

- Rekonstruksioni i rrugëve lokale nga f.Strelci deri f. Shtuovo/ Programi për ZHBR – zhvillimi i zonës urbane/ qershor-dhjetor 2021/ 5.025.858 denarë / qytetarët e Komunës së Kërçovës

- Rekonstruksioni i këndit të sportit në park rekreativ në Kërçovë/ Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave urbane/ qershor – dhjetor 2021/ 4.492.822 denarë /qytetarët e Komunës së Kërçovës

- Ndërtimi i murit mbështetës dhe rekonstruksioni i këndit të sportit në f.Osloj – Komuna e Kërçoves/ Programi për ZHBR- zhvillimi i zonave me nevoja specifike zhvillimore/ qershor-dhjetor 2021/ 5.509.571 denarë / qytetarët e Komunës së Kërçovës

- Rekonstruksioni dhe rregullimi i rrugëve në f. Belçisht – Komuna e Debërc / Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave me nevoja specifike zhvillimore/ qershor – dhjetor 2021/ 1.559.706 denarë / qytetarët e Komunës së Debërces

- Ndërtimi i rrugëve pjesa PR24, dhe pjesa PR 25 në v.b Pllasnica – Komuna e Pllasnicës/ Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave me nevoja specifike zhvillimore/ qershor – dhjetor 2021/ 2.000.000 denarë / qytetarët e Komunës së Pllasnicës

- Ndërtimi i rrugës me krah deri tek tokat bujqësore (varrezat) në vendin Pllasnicë – Komuna e Pllasnicës / Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave me nevoja specifike zhvillimore/ qershor – dhjetor 2021/ 3.000.000 denarë/ qytetarët e Komunës së Pllasnicës

Masa 1.4.2 - Nxitja dhe zhvillimi i infrastrukturës TIK në rajon

- nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 1.4.3 - Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale në rajon

- Rekonstrukcioni dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Jane Sandanski në Ohër/ Programi për ndërtimin e infrastrukturës komunale në Komunën e Ohrit/ prill- dhjetor 2021/ 15.231.078 denarë / qytetarët dhe vizitorët në Komunën e Ohrit

- ndërtimi i ujësjellësit në f. Dragov Dol – Makedonski Brod / MAJPH – Programi për menaxhimin me ujin/ shtator – tetor 2021/ 1.250.000 denarë/ qytetarët e Komunës së Makedonski Brodit

-Ndërtim i profilizimit me 4 linja në Komunën e Vevçanit/ Projekt bazik për infrastrukturën e ndërtimit të linjës së profilizimit në Komunën e Vevçanit/ Marrëveshje me koncesion e lidhur mes Republikës së Maqedonisë dhe TAV Maqedoni / tetor – dhjetor 2021/ 947.800 denarë / qytetarët e Komunës së Vevçanit

- Ndërtimi i gypave të ujësjellësit nga akumulimi deri tek rezervuari ekzistues në f.Srbica dhe f.Novo selo/ Programi për ZHBR – zhvillimi i fshatrave/ qershor -nëntor 2021 / 4.000.000 denarë / qytetarët e Komunës së Kërçovës

- Ndërtimi i profilizimit për ujërat e zeza në f. Volino – Komuna e Debërçes /Programi për ZHBR – zhvillimi i fshatrave/ qershor- nëntor 2021/2.608.375 denarë/ qytetarët e Komunës së Debërçes

Masa 1.4.4 - Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë

- Adaptimi i dokumentacionit projektues dhe teknik në pajtueshmëri me ligjin e ri për ndërtim, për ndërtimin e kolektorit Kalishtë – Radozhdë (Komuna e Strugës)/ Ndërtimi i kolektorit për ujërat e zeza dhe lidhja e tij me PSOV Vranishtë / korrik – dhjetor 2021/ 300.000 МКД / qytetarët e Komunës së Strugës

- Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtimet ndarëse, ndërtimi i tallozhnik dhe pastrimi i shtratit të lumit Sateska dhe studim fizibiliteti për ambientin jetësor/ janar – dhjetor 2021/ 4.920.000 denarë/ qytetarët e komunës së Strugës, Ohrit dhe Debërçes

- Përgatitja e dokumentit teknik për ndërtimin dhe rekonstrukcionin të linjave të profilizimit në komunën e Vevçanit krahu 20, krahu 21, krahu 22, krahu 23, krahu 24 dhe krahu 25/ MAJPH- Programi për investime na ambientin jetësor/ maj-dhjetor 2021/ 355.033 denarë/ qytetarët e komunës së Vevçanit

- Dokumentacioni teknik për ndërrimin e rrjetit ujësjellësi, gypave prej asbest dhe të betonit në qytetin e Strugës/ Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave urbane/ qershor – dhjetor 2021/ 750.000 denarë/ qytetarët e Komunës së Strugës

- Projekt bazik për ndërtimin e murit mbështetës PK 328,329/1,2609,2593, KO Pllasnicë / Programi për ZHBR – zhvillimi i fshatrave/ qershor – tetor 2021/ 1.016.000 denarë / qytetarët e Komunës së Pllasnicës

#### Prioriteti 1.5 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Masa 1.5.1- Krijimi i një sektori modern dhe produktiv bujqësor në rajon

-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.2 -Tejkalimi i problemeve aktuale në sektorin bujqësor, me qëllim për ta modernizuar

-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.3- Nxitje dhe zhvillim i ushqimit organik

-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.4 - Promovim të produkteve të njohura bujqësore dhe blegtorale nga rajoni dhe brendimi i tyre

-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.5 Masa për tejkalimin e pasojave që vijnë nga ndryshimet klimaterike në sektorin e bujqësisë

-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.6 Masa stimulese për rritjen e plantacioneve bujqësore autokone dhe kultivimi i llojeve të bimëve autokone

-nuk ka aktivitete të realizuara

**Qëllimi strategjik 2 - Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara.**

Prioriteti 2.1. Përmirësimi i kualitetit të arsimit dhe përshtatja e nevojave në pajtim me kërkesat e tregut të punës

Masa 2.1.1 - Inicimi i programeve arsimore sipas nevojave të sektorit të biznesit, gjegjësisht tregut të punës

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.1.2 - Vendosja e pajisjeve laboratorike dhe kabineteve përkatëse bashkëkohore tek shkollat e mesme

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.1.3 - Nxitja e inovacionit në arsimin e mesëm

- Kampe për inovacion për nxënësit e shkollave të mesme në bashkëpunim me Junior Achievement MK / fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik, Agjencinë Amerikanë për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Shparkase bank / mars 2021, qershor 2021 / 600.000 denarë/ nxënësit e shkollave të mesme nga e gjithë shteti

2.1.4 Rritja e kapacitetit të stafit mësimdhënës në shkollat e mesme dhe përfshirja në programet arsimore të BE-së

- nuk ka aktivitete të realizuara

2.1.5. Krijimi i orientacionit të karrierës në shkollat e mesme duke eliminuar stereotipet gjinor

- nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 2.2 Nxitja e bashkëpunimit mes arsimit dhe biznes sektorit

Masa 2.2.1 - Inkurajimi i orëve arsimore praktike të detyrueshme në shkollat e mesme

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.2 - Vizita në panairët e teknikës dhe teknologjisë të destinuara për shkollat e mesme profesionale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.3 - Krijimi i bazave të profileve të nevojshëm nga arsimit mesëm në APRMV dhe ndërmjetësimi i tyre në procesin e ofertës dhe kërkesës

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.4 - Rikualifikim, mësim gjatë gjithë jetës në përputhje me nevojat e sektorit të biznesit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.5 - Programi i mentorimit dhe praktikës sidomos për vajzat në STEM (inxhinieri, teknologji, industri) dhe për djemtë në arsim, mbrojtje sociale dhe përkujdes social.

- nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 2.3 Parandalimi i largimit të profesionistëve të rinj nga rajoni

Masa 2.3.1 - Krijimi i mundësive të punësimit për të rinjtë e arsimuar përmes masave stimuluese shtetërore që do të zbatohen nga komunat

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.3.2- Krijimi i masave stimuluese për punësimin e të rinjve në zonat rurale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.3.3 - Masat stimuluese për punësimin dhe zgjidhjen e kushteve sociale për personat e kthyer

- nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 2.4 Mundësi të barabarta për të gjithë në tregun e punës

Masa 2.4.1- Masa stimuluese për punësimin e femrave

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.4.2 - Krijimi i kushteve për qasje deri tek vendet e punës për kategoritë e rrezikuara sociale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.4.3 - Përfshirje sociale si sfidë për integrimet në BE

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.4.4 - Përkrahja e parimit të solidaritetit për kategoritë më të rrezikuara në shoqëri



- nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 2.5 Qasje e barabartë tek shërbimet për të gjithë qytetarët në rajonit

Masa 2.5.1 Rritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe qasje për të gjitha kategoritë e qytetarëve

-Rekonstrukcioni dhe vendosja e pajisjeve në qendrën bashkëkohore për terapi fizikale në spitalin Shën.Erazmo në Ohër/ janar -maj 2021/ 7.935.310 denarë/ pacientët të cilët vinë në spitalin Shën Erazmo nga i gjithë shtetit dhe shtetet fqinje

- Forumet rajonale/ Mbështetje e Qendrës për zhvillim të RPJP – Projekt ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv/ prill-qershor 2021/84.200 denarë/ përfaqësues nga të gjithë palët e interesuara

Masa 2.5.2 Përmirësimi i kujdesit shëndetësor primarë në zonat rurale të rajonit

-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.5.3 Përfshirja sociale e të moshuarve dhe personave të pamundshëm

- Rekonstrukcioni i hapësirës në Qendrën ditore për personat e moshuar dhe pensionistë në Vevçan / Projekti “Fuqizimi i këshillave komunal” – UNDP-SDC/ tetor 2020-prill2021/183.313 denarë/ personat të moshuar në Komunën e Vevçanit

- Furnizimi me pajisje klimaterike dhe televizor për nevojat e Qendrës ditore për persona të moshuar dhe pensionistë në Vevçanë/ Projekti “Fuqizimi i këshillave komunal” – UNDP-SDC/ tetor 2020-prill. 2021/126.850 denarë/ personat të moshuar në Komunën e Vevçanit

Masa 2.5.4 Përfshirja sociale për kategoritë e qytetarëve të izoluar nga shoqëria duke hapur qendra të për kujdesit ditor

- Nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 2.5.5 Krijimi i kushteve për pranimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe

- Rekonstrukcioni dhe adaptimi i hapësirave në JOUDG Planinski cvet në Vevçanë/ Projekti “Fuqizimi i këshillave komunal” – UNDP-SDC/ tetor 2020-prill2021/2.727.553 denarë/ fëmijët e moshës parashkollore në Komunën e Vevçanit

Masa 2.5.6 Rritja e numrit të akomodimit të nxënësve dhe studentëve në objektet e organizuara – konvikte

- Nuk ka aktivitet të realizuara

**Qëllimi strategjik 3 - Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë të avancuara janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të veçantë në RPJP.**

#### Prioriteti 3.1 Përmirësimi i qasjes dhe rregullimi i lokaliteteve turistike

Masa 3.1.1 Përgatitja e dokumentacionit urbanistik për rregullimin e lokaliteteve turistike në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.1.2 Mapimi i rariteteve natyrore dhe kulturore në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.1.3 Infrastruktura rrugore në vendet turistike të përshtatura për personat me nevoja të veçanta

- nuk ka aktivitete të realizuara

3.1.4 Sigurimi i informacionit, sinjalizimit dhe vizualizimit të atraksioneve turistike 3.1.5 Rivitalizimi i lokaliteteve të rëndësishme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore

- Qendra turistike Vevčan – Një qendër një produkt turistik/Projekt për konkurrencën lokale dhe rajonale (PLRK)- EU Banka botërore/ maj 2018 – shtator 2021/61.078.166 denarë / vizitorët në Komunën e Vevčanit

Masa 3.1.5 Rivitalizimi i lokaliteteve të rëndësishme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore

- Nuk ka aktivitete të realizuara

### Prioriteti 3.2 Tejkalmi i karakterit sezonal të turizmit në rajon

Masa 3.2.1 Krijimi i paketave turistike rajonale

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.2.2 Rishpërndarja e vizitorëve nga qendrat e njohura turistike në pjesën tjetër të rajonit

- Rekonstrukcioni i parkut që ndodhet në afërsi të urës së lumit Treska në Makedonski Brod/ Programi për zvogëlimin e dispariteteteve dhe rritjes së konkurrencës rajonale MVL/ qershor – dhjetor 2021/ 3.000.000 denar/ qytetarët dhe vizitorët në Makedonski Brod

- Rekonstrukcioni i kalas Kitino në Kërçovë / Programi për konkurrencë lokale dhe rajonale (PLPK) EU Banka Botërore / maj 2018 – shtator 2021/ 39.360.000 denarë/ qytetarët dhe vizitorët në Kërçovë

Masa 3.2.3 Tërheqja e investimeve të brendshme dhe të huaja për zhvillimin e kapaciteteve akomoduese në brendësi të rajonit

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.2.4 Zhvillimi dhe promovimi i manifestimeve lokale që do të jenë atraktive për vizitorët vendas dhe të huaj gjatë gjithë vitit

- Nuk ka aktivitete të realizuara

### Prioriteti 3.3 Nxitja dhe zhvillimi i formave alternative të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike

Masa 3.3.1 Zhvillimi i turizmit malor në rajon

- Mundësi të reja për turizëm të sigurtë aventurist dimëror /EU IPA “ Programi CBC MK-AL/ janar – dhjetor 2021/12.058.100 denarë/ Kryqi i kuq Ohër, Klubi i alpinistëve Patagonija Ohër, Komuna e Debërces, alpinistë dhe të a pasionuarit pas sportit dimëror prej të gjithë rajonit

Masa 3.3.2 Avancimi i turizmit speleologjik në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.3.3 Zhvillimi dhe avancimi i mundësive për aktivitete dimërore në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.3.4 Zhvillimi dhe avancimi i agro-turizmit në rajon

- Promovimi i kulturës ekonomike për zhvillimin e turizmit dhe agro biznesit në rajonin e Kërçovës / Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave me nevoja specifike/ qershor – dhjetor 2021/ 1.000.000 denarë/qytetarët dhe vizitorët në Komunën e Kërçovës

Masa 3.3.5 Zhvillimi i bizneseve lokale si mbështetës i aktiviteteve turistike në brendësi të rajonit

- Nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 3.4 Përmirësimi i menaxhimit me destinacionet turistike

Masa 3.4.1 Krijimi i planeve nga NJVL për menaxhim me destinacionet

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.2 Trajnimi i kuadrit për menaxhim me destinacionet turistike

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.3 Tërheqja e fondeve për rregullimin e destinacioneve turistike lokale

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.4 Strategji marketingu për promovimin e destinacioneve turistike lokale

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.5 Krijimi i ofertave lokale për të vizituar destinacionet turistike

Nuk ka aktivitete të realizuara

#### Prioriteti 3.5 Mbrojtja e ambientit jetësor

Masa 3.5.1 Krijimi i sistemit rajonal integrues për menaxhimin me mbeturinat

- Furnizimi me traktorë NPK Higjiena Komunale në Makedonski Brod/ Programi për ZHBR – zhvillimi i zonave urbane dhe zhvillim urban i qëndrueshëm / qershor- dhjetor 2021/ 1.500.000 denarë / NPK Higjiena Komunale – Komuna e Makedonski Brodit

- Furnizimi me mjetë komunal për mbeturina – NPK Komuna e Qendër Zhupë/ Programi për ZHBR- zhvillimi i zonave me nevoja të veçanta zhvillimore/ qershor – nëntor 2021/ 4.500.000 denarë ? NPK Komuna e Qendrës Zhupë

- Furnizimi me pajisje të re për në teren për nevojat e JP Komunalec – Pllasnicë – Komuna e Pllasnicës / Programi për ZHBR – zhvillimi i fshatrave / qershor – tetor 2021/ 984.000 denarë/ NPK Kumunalec – Komuna e Pllasnicës

Masa 3.5.2 Masa për zgjidhjen e problemit me qentë endacak në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.3 Mbrojtja e biodiversitetit në rajon

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.4 Masa për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.5 Masa për mbrojtjen ujërave nga ndotja

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.6 Masa për mbrojtjen e tokës nga ndotja

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.7 Marrja e masave për tejkalimin e problemeve që vijnë nga ndryshimet klimaterike

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.8 Masa për menaxhimin e rreziqeve që vijnë nga fatkeqësitë elementare

- Nuk ka aktivitete të realizuara

### Prioriteti 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë

Masa 3.6.1 Masa stimuluese për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.6.2 Zvogëlimi i shfrytëzimit të derivateve fosile si energji në industri dhe amvisëri

- Nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.6.3 Përmirësimi i energjisë efikase në objektet publike

- Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe kontroll energjetik për EE në objektet publike / Kontroll energjetik në 11 objekte / Programi për ZHBR – zhvillimi i rajoneve planore / prill – tetor 2021 / 593.310 denarë/ qytetarët në 9 komuna të rajonit planor Jugperëndimor

- Përgatitja e dokumentacionit teknik për kontroll energjetike për EE në objektet publike / Dokumentacion teknik për 12 objekte / Programi për ZHBR – zhvillimi i rajoneve planore/ prill – tetor 2021/ 1.580.099 denarë/ qytetarët e 9 komunave të rajonit planor Jugperëndimor

Masa 3.6.4 Masa stimuluese për energji efikase në amvisëri

- |  |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"><li>- Nuk ka aktivitete të realizuara</li></ul> <p>Masa 3.6.5 Mbështetje të iniciativave për prodhimin e energjenteve alternative ekologjike</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Nuk ka aktivitete të realizuara</li></ul> |
|--|

Në kuadër të **Qëllimit strategjik 1** - Avancimi i ekonomisë dhe paritetin gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive krahasimore të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji të reja, njohuri dhe inovacion, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësi dhe zhvillim rural, janë realizuar gjithsej **44** aktivitete.

Në kuadër të projektit **Qëllimi strategjik 2** - Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara, janë realizuar **9** aktivitete.

Në kuadër të **Qëllimi strategjik 3** - Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë të avancuara janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të veçantë në RPJP, janë realizuar gjithsej **46** aktivitete

Numri i përgjithshëm i aktiviteteve të realizuara nga projektet për të tre qëllimet strategjike është 99.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor gjatë vitit 2021 përgatiti 4 projekt aplikacione. Nga të cilat 3 projekt aplikacione u pranuan dhe u financuan.

## 2. Sigurimi i transparencës gjatë realizimit të Programit

Më këtë pjesë janë prezantuar të dhënat për rezultatet e arritura në pjesën e transparencës gjatë realizimit të Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Kah fundi i vitit 2020, Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, me ndihmën e Agjencionit Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim, e lëshoi në përdorim web faqen e re të Qendrës ([www.southwestregion.mk](http://www.southwestregion.mk)). Nga janari i vitit 2021, web faqja e re është plotësisht funksionale. Gjegjësisht, ekipi i Qendrës, bashkërisht me operatorin ekonomik – përgatitësi i web faqes, gjatë të gjithë procesit punuan në adaptimin e përmbajtjeve të vjetra që të njëjtat të vendohen në versionin e ri të web faqes. Po ashtu, u përgatiten materiale të reja, tekste dhe përmbajtje të tjera me qëllim që puna e Qendrës të jetë sa më transparente.

Në lidhje me punën e Qendrës për zhvillim, u vendosen materiale nga projekte të realizuara prej viti 2009 deri në fund të vitit 2021, me aktivitetet kryesore, indikatorët dhe rezultatet e projekteve, si dhe raportet dhe fotografitë nga të njëjtët. Të gjitha materialet janë vendosur në 3 gjuhë (maqedone, shqipe dhe në gjuhën angleze). Gjatë vitit 2021, të gjitha projektet janë adaptuar dhe u azhurnuan në web faqen e re, dhe atë gjithsej 56 projekte, (si shtojcë linku i projekteve: <https://southwestregion.mk/proekti/>)

Për punën e Këshillit për zhvillim, u vendosen materialet siç janë: Ftesa dhe Rendi i ditës për seancat e Këshillit për zhvillim të RPJP, lista e pjesëmarrësve të ftuar në seanca, Procesverbalet, fotografit, materialet nga projektet etj. Gjatë vitit 2021 u mbajtën 6 seanca të Këshillit. Dhe për të njëjtat janë publikuar informacionet përkatëse në web faqen e Qendrës. (si shtojcë linku nga Seancat: <https://southwestregion.mk/odnosi-so-javnosta/sednici/>).

Në web faqen e Qendrës për zhvillim, gjatë vitit 2021, u vendosen edhe materiale të tjera, dokumente, programi, plani për punë i Qendrës, si dhe realizimi i Programit për zhvillim. Gjithashtu, u vendosen: Programi për zhvillim

i RPJP për periudhën 2021-2026 ( në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Plani vjetor i propozim projekteve rajonale për vitin 2021 ( në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Strategjia për zhvillim rajonal për periudhën 2021-2031 ( në gjuhën maqedonase), Raporti vjetor i punës së Qendrës për zhvillim për vitin 2020 dhe Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim për vitin 2020 ( në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim për vitin 2021 ( në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Llogarit përfundimtare për vitin 2020, edhe atë ç[r Qendrën për zhvillim dhe për Projektet: ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv (në gjuhën maqedonase), Plani vjetor financiar për vitin 2021 dhe 2022 dhe Raporti vjetor financiar për vitin 2020 (në gjuhën maqedonase dhe shqipe).

Në lidhje me furnizimet publike, u publikua Plani për furnizime publike për vitin 2021 (në gjuhën maqedonase). Në këtë pjesë është e rëndësishme të përmendet, se me web faqen e re, u bë sinkronizimi i faqes së Qendrës për zhvillim me sistemin për e-furnizime i cila publikohet edhe në faqen e Qendrës për zhvillim. (linku:<https://southwestregion.mk/javni-nabavki/>)

Në pjesën me Marrëdhënie me publikun, gjatë vitit 2021, u publikuan 8 lajme (në 3 gjuhë), publikime për të 6 seancat e Këshillit për zhvillim (në tre gjuhët) dhe 2 Shpallje (në 3 gjuhët).

Gjithashtu, Biznes qendra, i përgatiti dhe i adaptoj listat me aktorët më të rëndësishëm të rajonit në pjesën e komunitetit të biznesit ( të ndara në 12 fusha të veprimit), bashkësia qytetare dhe Institucionet akademike (fillore, të mesme dhe institucionet e arsimit të lart në rajon). Për komunitetin e biznesit u vendosen të dhënat me kontaktet për 921 ndërmarrje, për bashkësinë e qytetarëve u vendosen të dhënat me kontakte për 1164 organizata, dhe për institucionet arsimore të dhënat për 39 shkolla fillore, 9 të mesme dhe 6 institucione të arsimit të lartë.

Gjatë vitit, konkretisht 2021, web faqen e Qendrës për zhvillim të RPJP e kanë vizituar 5.500 vizitorë. Numri më i madh i vizitorëve janë nga Republika e Maqedonisë së Veriut pastaj vijon me shtetet fqinje, dhe si blloku i tret janë shtetet nga BE.

Në “Facebook” faqen e Qendrës për zhvillim, gjatë vitit 2021, janë publikuar dhe shpërndarë gjithsej 580 informacione. Shumica e publikimeve janë për mundësit për financimin e kompanive private, pastaj janë publikuar grantet për institucionet, promovimi i projekteve të Qendrës për zhvillim, Komunat e rajonit, ndërmarrjet publike komunale nga rajoni, dhe institucionet e tjera relevante nga rajoni planor Jugperëndimor (linku i “Facebook faqes: <https://www.facebook.com/Jugozapadenplanskiregion>). Për të gjitha publikimeve ka 1700 reagime pozitive nga ana e vizitorëve në FB faqen e Qendrës për zhvillim.

Qendra për zhvillim, në suaza të mundësive të veta, për aktivitetet e rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me përditshmërinë e punës, u mbuluan përmes medimeve nacionale, rajonale dhe lokale të shkruara dhe medimeve elektronike. Është e rëndësishme të theksohet se rregullisht me fragmente, që ishin të lidhura me aktivitete konkrete nga projektet, gjatë vitit 2021 ka pasur në Agjencinë Informativ të Maqedonisë – MIA, përmes korrespondentëve të tyre në Ohër, Strugë, Kërçovë dhe Dibër, si dhe tek Radio Televizioni i Maqedonisë, ndërsa nga mediumet e shkruara në gazetatat ditore Nova Makedonija dhe Koha.

Qendra për zhvillim, bashkëpunoj me një numër të madh të medimeve rajonale, siç janë profilet televizive TVM në Ohër, TV Gura në Kërçovë dhe TV Zhupa në Dibër, konkretisht u dhanë deklaratat të kryetarit të Këshillit për zhvillim të RPJP, Ramiz Merko, kryetarët e komunave dhe nga drejtorja e Qendrës për zhvillim, Mirjana Loanoska për ngjarje të rëndësishme për rajonit, për fillimin e aktiviteteve të projektit, dhënien e deklaratave dhe për tema të tjera të rëndësishme, si dhe pjesëmarrje në emisione. Nga internet portalet informacione për aktivitetet e Qendrës ka dhënë Ohridnews, i cili e mbulon pothuajse të gjithë rajonin dhe është një nga mediumet në internetit më i rëndësishmi në të gjithë vendin.

Gjatë vitit 2021 në medime u publikuan për afërsisht 50të publikime për aktivitet të ndryshme që kanë të bëjnë për Këshillin për zhvillim, Qendrën për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

### 3. Sigurimi i participimit për realizimin e Programit

Në këtë pjesë prezantohen të dhënat për rezultatet e arritura në pjesën e participimi, si një nga parimet ligjore e definuar në politikat për zhvillimin e barabartë rajonal. Duhet ti jepet një rëndësisë të veçantë procesit të përgatitjes, mbajtjes dhe rezultateve nga puna e forumeve rajonale në bashkësi. Po ashtu, duhet të ceket numri i forumeve rajonale të mbajtura, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në forumet rajonale, numri mesatar i pjesëmarrësve për çdo forum të mbajtur, si dhe struktura e të dhënave të pjesëmarrësve.

Gjithashtu, është e nevojshme të ceket edhe pjesëmarrja sipas përqindjes në projekte të cilat u zgjedhën në forume nga numri i përgjithshëm i projekteve të realizuara nga ana e Qendrës për zhvillim të rajonit.

Për veç kësaj, për pjesën e projekteve dhe aktiviteteve ku nuk janë realizuar forume rajonale të bashkësi duhet të theksohet: a duhet, si dhe në çfarë raste duhet të zbatohet metoda të tjera dhe mekanizma për participim.

Participimi për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është një nga principet themelore i cili zbatohet nga fillimi i funksionimit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Çdo vit Qendra organizonte punëtori planifikuese në të cilën merrnin pjesë përfaqësues nga të gjithë palët e interesuara në rajonin planor Jugperëndimor. U identifikuan problemet në rajon dhe u propozuan zgjidhje nga ana e përfaqësuesve të komunave, ndërmarrjet publike, biznes sektori, organizatat joqeveritare, institucionet arsimore dhe shëndetësore, dhe persona individual të interesuar. Të gjitha projekt idetë të gjeneruara u harmonizuan me qëllimet strategjike dhe prioritetet me Programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Me fillimin e implementimit të projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, dhe me ndryshimet me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal, këto punëtori planifikuese u zhvilluan në forume rajonale në përputhje me Agjencinë Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe BNJVL. Në forumet u angazhua moderator i certifikuar nga BNJVL dhe në pajtueshmëri me rregullat, ftesa dhe rendi i ditës u dërgohet të gjithë palëve të interesuara nga rajoni. Në mënyrë standarde u organizuan cikli prej katër forume me numër të definuar të tavolinave të punës sipas fushave të prioritizuara. Në sesionin e parë të forumit u identifikuan problemet dhe u propozuan zgjedhjet. U krijuan grupet e punës të cilat punuan në koncept projektet e propozuara dhe të njëjtët u prezantuan para pjesëmarrësve në sesionin e dytë dhe të tretë të forumeve. Në sesionin e tretë të gjithë pjesëmarrësit me të drejt vote, votuan dhe me këtë e krijuan listën e prioritetëve të projekteve për rajonin. Në sesionin e katërt të forumit u prezantuan rezultatet nga implementimi i projektit të zgjedhur nga ana e forumit.

Në kushte normale numri mesatar i pjesëmarrësve në forume është 60. Në forume morën pjesë femra dhe meshkuj, përfaqësues nga të gjithë sektorët, përfaqësues nga të gjithë grupet etnike, përfaqësues nga grupet e rrezikuara të qytetarëve.

Për shkak të pandemisë por edhe për shkak të miratimit të Ligjit të ri për ZHBR, ndryshimeve të tij, pastaj ndryshimeve në Programin ZHBR të BZHR, në vitin 2021 është mbajtur vetëm një forum - forum final për prezantimin e rezultateve nga realizimi i projektit investues i cili u financua nga Skema e Granteve nga projekti Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv. Sesioni i katërt i forumit u mbajt më 15 qershor 2021 në Strugë dhe moderator ishte Aleksandar Jovanovski i cili është moderator i certifikuar nga BNJVL. Në të morën pjesë 36 pjesëmarrës, nga të cilët: 19 përfaqësues të institucioneve publike dhe komunave të rajonit, 10 përfaqësues të sektorit civil, 1 përfaqësues të mediave dhe 5 përfaqësues të Qendrës për Zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor. Përkatësia gjinore ishte 16 meshkuj dhe 20 femra, ndërsa sipas përkatësisë etnike 22 përfaqësues janë maqedonas, 12 shqiptarë, 1 turk dhe 1 romë. Sa i përket grupeve vulnerabël, vetëm dy pjesëmarrës deklaruan se i përkasin grupit të kategorive vulnerabël.

Siç u përmend në fillim, Qendra për zhvillim e RPJP ka përdorur vazhdimisht mjete për pjesëmarrje në formën e punëtorive planifikuese dhe vitet e fundit në formën e forumeve rajonale, ku propozohen dhe përzgjidhen projekte prioritare. Të gjitha projektet e përzgjedhura dhe të realizuara janë në përputhje me Programin për zhvillimin të rajonit dhe lirisht mund të thuhet se të gjitha janë përzgjedhur përmes punëtorive dhe forumeve, gjegjësisht me konsultim të gjerë me të gjitha palët e interesuara.

#### 4. Sigurimi i përfshirjes sociale në realizimin të Programit

Në këtë pjesë janë paraqitur vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për kontributin dhe rezultatet e arritura në fushën e përfshirjes sociale në zbatimin e Programit për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Në të gjitha projektet e realizuara rajonale, është marrë parasysh përfshirja sociale e grupeve vulnerabël të qytetarëve.

Aktivitetet e Qendrës së biznesit janë në dispozicion për të gjitha kategoritë e qytetarëve, duke përfshirë edhe kategoritë e rrezikuara. Gjatë publikimit të mundësive për financim të sektorit të biznesit, sesioneve informative, mbështetjes mentoruese për thirrjet e FIZHT-it, kampeve të inovacionit, njoftimeve në FB, etj., Qendra për zhvillim u drejtohet të gjithë aktorëve në sektorin e biznesit, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, prindërit e vetëm, të papunësuarin për një periudhë afatgjate, njerëz që punojnë në ekonominë e zezë dhe të gjithë të tjerët që janë me rrezik social.

Projektet rajonale, masat për zbatimin përfshijnë përmirësime në infrastrukturën komunale, trajtojnë gjithashtu përfshirjen sociale të komuniteteve lokale dhe nga zonat urbane dhe rurale. Gjithashtu është bërë lidhje ekonomike mes personave të izoluar në zonat rurale nëpërmjet ndërtimit të rrugëve të aksesueshme në tokën bujqësore.

Në vitin 2021 u mbajt forumi i katërt rajonal për prezantimin e rezultateve të arritura nga projekti investues. Të tre forumet e mëparshme që ishin pjesë e ciklit të katër sesioneve të forumeve rajonale kishin për qëllim identifikimin e problemeve dhe propozimin e zgjidhjeve në të cilat do të jetë i detyrueshëm komponenti i përfshirjes sociale, në përputhje me kriteret e donatorit. Në forume morën pjesë përfaqësues nga të gjitha fushat, përfshirë kategoritë e rrezikuara të qytetarëve.

Përkthimi i Programit për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor në gjuhën shqipe u mundëson qasje në atë dokument më shumë qytetarëve nga rajoni Jugperëndimor që i përkasin bashkësisë etnike shqiptare.

Trajnim për fuqizimin e aftësive për të punësuarit në Qendër, për transparencë përmes përmirësimit të sistemit të komunikimit përmes rrjeteve sociale, gjithashtu do të mundësoj më shumë informacione për të gjithë kategoritë e qytetarëve duke i përfshirë edhe grupeve të kategorisë së qytetarëve të rrezikuar.

Me realizimin e projektit “Rekonstruksioni dhe vendosja e pajisjeve në qendrën bashkëkohore për terapi fizikale në spitalin Shën. Erasmo” u dha mundësia për shërimin e pacientëve të cilët kanë nevojë për terapi hidrofizikale, siç janë fëmijët me probleme në zhvillim, personat e rritur të cilat kanë sëmundje de generative dhe të gjithë grupet e tjera të cilat kanë probleme shëndetësore të këtij lloji. Me fillimin me punë të pishinës nga korriku 2021 deri në fund të vitit numri mesatar i pacientëve të cilat marrin hidroterapi varion deri në 30 në ditë, ose gjithsej 3300 pacient në periudhën e cekur.

Me projektin rajonal “Përgatitja e dokumentit teknik për kontroll energjetik për EE në objektet publike” janë bërë 11 kontrolle energjetike me raporte dhe janë përgatitur projekte teknike me masa të efikasitetit energjetik për 12 objekte publike në rajoni Jugperëndimor. Shumica e këtyre objekteve publike janë shkolla fillore dhe të mesme, shtëpi të fshatit dhe objekte të bashkësive në zona rurale. Me këto mundësi të krijuara për përmirësimin e kushteve të gjithë kategorive duke i përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijë të izoluar në zona rurale, persona nga bashkësitë e tjera dhe persona të tjerë që janë në rrezik social.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti i përfshirjes sociale në zbatimin e secilit projekt ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt / aktivitete	Komponenti për inkluzion social	Indikator/e
----------	----------------------	---------------------------------	-------------



1.	Ndërtimi i rrugëve deri tek tokat bujqësore në RPJP	Lidhje ekonomike të personave të izoluar në hapësirat rurale	200 bujq nga zona rurale (Vevçanë)
2.	Qendra e biznesit	Kyçja e personave me aftësi të kufizuar, familje me një prind, persona të papunësuar për afat kohor të gjatë, personat që punojnë në ekonominë e zezë dhe të tjerët që me status të rrezikuar social	150 persona të kyçur dhe me status social të rrezikuar
3.	Rekonstruksioni dhe vendosja e pajisjeve në qendrën bashkëkohore për terapi fizikale në spitalin Shën. Erazmo	Terapi hidro fizikale për fëmijët me pengesa në zhvillim, personat e rritur me sëmundje degenerative	3300 pacient korrik – dhjetor 2021
4.	Përgatitja e dokumentacionit teknik për kontrollin energjetik për EE në objektet publike	Kyçja në arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, fëmijë që janë të izoluar në zonat rurale, përfaqësues nga komuniteti	220 persona me nevoja të veçanta, 20 persona të moshuar, 906 fëmijë dhe të rinj nga zonat e izoluar rurale, 3090 përfaqësues nga komuniteti
5.	Forumet rajonale	Kyçja e personave me aftësi të kufizuar, persona nga zonat e izoluar rurale, persona të papunësuar për një kohë të gjatë, përfaqësues nga komuniteti	36 nxënës, 10 SHJQ, 1 medium, 22 maqedonas, 12 shqiptar, 1 turk, 1 rom, 2 pjesëmarrës nga grupet e rrezikuara
6.	Përktimi i Programit për zhvillim të RPJP në gjuhën shqipe	Përfshirja e përfaqësuesve nga bashkësia shqiptare	Bashkësia shqiptare e cila është e dyta sipas popullsisë në rajonin Jugperëndimor
7.	Trajnim për transparencë përmes përmirësimit të sistemit të komunikimit në rrjetet sociale	Kyçja e personave të rritur dhe me aftësi të kufizuar, personave të izoluar në zonat rurale, personat të papunësuar për një kohë të gjatë, përfaqësuesit nga komunitetet	1500 ndjekës në profilin e FB dhe në rrjetet sociale

## 5. Sigurimi i barazisë gjinore në realizimin e Programit

Në këtë pjesë është prezantuar vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për progresin e arritur dhe rezultatet e arritura në pjesën e barazisë gjinore në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, me theks të veçantë për përgjegjësinë buxhetore gjinore.

Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor viti 2021 -2026, në pjesën e barazisë gjinore dhe përgjegjësi gjinore buxhetore, është përgatitur në pajtueshmëri me konventën ndërkombëtare të pranuar dhe dokumentet që janë miratuar në vend, duke marrë parasysh Strategjinë për barazi gjinore në RMV. Gjithashtu, gjatë përcaktimit të qëllimeve strategjike, prioriteteve dhe masave është marrë parasysh parimi për realizimin e mundësive të barabarta, gjegjësisht mundësimi i meshkujve dhe femrave të marrin pjesë në planifikimin dhe krijimin e aktiviteteve kryesore në Rajon, përmes punës të Këshillit dhe Qendrës për zhvillim, si dhe përmes angazhimit të palëve të tjera të interesuara në nivel lokal - Komuna, akademik, sektori i biznesit dhe OJQtë.

Gjithashtu, janë marr parasysh dhe parimet për statusin dhe trajtimin të njëjtë në realizimin e të drejtave të tyre, si dhe barazi në shfrytëzimin e përfitimeve/efekteve nga rezultatet e arritura nga projekti.

Nga këndvështrimi i buxheti mit të projekteve, dhe pjesa e aktiviteteve të planifikuara, u shpreh dëshira e barazisë gjinore, përmes organizimit të forumeve rajonale me zbatimin të praktikave të pjesëmarrjes në procesin e buxheti mit. Kjo d.m.th. se janë marr parasysh dallimet gjinore, nevojat dhe interesat në sektorët në të cilat implementohen projektet: infrastruktura rrugore, bujqësia, arsimi, mbrojtja sociale dhe në sektorin e biznesit.

Me aktivitetet e realizuara, rezultate domethënëse ( përmes të dhënave/indiktorët e matshëm të pasqyruara në tabelën e më poshtme) janë arritur në:

- barazi gjinore në sektorin e bujqësisë, nxitja/zmadhimi i roli të grave dhe të rinjve në menaxhimin e veprimtarive bujqësore, në veçanti në bizneset familjare që janë të lidhura me këtë sektor,
- u mundësuan shërbime të reja në sektorin shëndetësor, të cilat ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes shëndetsore tek popullat e re, tek personat e rritur të cilët kanë nevoj për tretman fizikal me qëllim rehabilitimin e tyre,
- Janë arritur rezultate të rëndësishme në avancimin e procesit arsimor dhe sferës sociale me mundësinë e qasjes më të lehtë për të gjithë nxënësit (pa dallim gjinie, etnike, sociale apo përkatësi tjetër), dhe për stafin arsimor, si dhe në tejkalimin e disproporcionet të përdoruesve të shërbimeve sociale, dhe
- Sigurimi i aksesit më të lehtë deri tek burimet e financimit për biznes idet të popullatës femërore, nëpërmjet trajnimeve për përgatitjen e planeve të biznesit dhe aplikacioneve të projekteve konkrete (FIZHT, Horizon 2020...) dhe inkurajimit të sipërmarrjes femërore.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti i barazisë gjinore gjatë zbatimit të projekteve të veçanta ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt / aktivitet	Komponenti për barazi gjinore	Indikator/e
1.	Ndërtimi i rrugëve deri tek tokat bujqësore në RPJP	Mundësi të barabarta për shfrytëzimin e infrastrukturës rrugore deri tek sipërfaqet bujqësore për të gjithë gjinitë në bashkësi	Numër: qasje deri tek toka punuese prej 144 hektar për 200 bujq në Vevçanë  Vlerësimi: Krijimi i kushteve për zhvillimin e biznesit familjar në bujqësi duke i përfshirë të gjithë anëtar të amvisëria
2.	Rekonstruksioni dhe vendosja e pajisjeve në qendrën bashkëkohore për terapi fizikale në spitalin Shën. Erazmo në Ohër	Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e fëmijëve me anomali dhe rehabilitim i personave të rritur me deformime nga të gjithë kategorive gjinore	Numër: 30 pacient në ditë me nevoja për rehabilitim  Vlerësimi: U mundësuan terapist fizikale për nxitjen e rritjes të shëndetshme tek fëmijët dhe shërimi i personave të rritur pa dallim gjinor.
3.	Përgatitja e dokumentacionit teknik për kontroll	Krijimi i kushteve për mundësi të barabarta për të gjitha kategoritë gjinore në veçanti në sferën e arsimit dhe sferën sociale	Numri: Përmirësimi i kushteve për qëndrim në institucionet të sferës arsimore dhe sociale për 220 persona me nevoja të

	energjetike për EE në objekte publike		veçanta, 20 persona të pamundur, 906 fëmijë dhe të rritur të izoluar në zona rurale dhe 3090 përfaqësuese nga bashkësitë Vlerësimi: krijimi i kushteve për qasje të barabartë në sferën arsimore dhe sociale përmes përmirësimit të kushteve të dhënies/ marrjes së shërbimeve për të gjitha gjinitë
4.	Aktivitetet e biznes qendrës	Krijimi i kushteve për mundësi të barabartë për të gjithë kategoritë gjinore, në veçanti të grupeve të shkyçura (grupet e rrezikuara, persona nga zonat rurale, persona me aftësi të kufizuar, persona të përfshirë në ekonominë e zezë..), si dhe të rejave nga gjinia femërore dhe përfshirja e tyre në sektorin e biznesit	Numër : 150 persona të përfshirë në aktivitetet e Biznes Qendrës  Vlerësimi: U mundësua përfshirja në tregun e punës dhe hapjen e mundësive për zhvillim të biznesit vetanëk përkatësisht për grupet qëllimore të cilat janë cekur
5	Forumet rajonale	Mundësi të barabarta për përfshirjen të të gjitha kategorive gjinore	36 pjesëmarrës në forumet rajonale, prej të cilave 20 janë femra dhe 16 meshkuj
6	Përkthimi i Programit për zhvillim të RPJP në gjuhën shqipe	Krijimi i kushteve për mundësi të barabartë për të gjitha kategoritë gjinore	Program i aksesueshëm për të gjithë të rriturit, meshkuj dhe femra e interesuar nga bashkësia shqiptare
7	Trajnim për transparencë për përmirësimin e sistemit të komunikimit në rrjetet sociale	Mundësi të barabarta për përfshirjen të të gjitha kategorive gjinore	1500 ndjekës nga të cilët % më e madhe janë femra

## 6. Kontribut kah mbrojtja e ambientit jetësor gjatë realizimit të Programit

Në këtë pjesë është prezantuar vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për progresin e arritur dhe rezultatet e arritura në pjesën e mbrojtjes dhe avancimin e ambientit jetësor në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Në të gjitha projektet rajonale të realizuara i kushtohet vëmendje mbrojtjes së ambientit jetësor.

Aktivitetet e Qendrës së Biznesit nuk kanë ndikim negativ në ambientin jetësor duke pasur parasysh natyrën e tyre. Domethënë, publikimi i informacionit, sesionet informative, mbështetja mentoruese për thirrjet e FIZHT-ke, kampet e inovacionit që u zhvilluan Online, njoftimet në FB, etj., nuk kanë asnjë ndikim negativ mbi ambientin jetësor

Forumet rajonale, përkthimi i Programit në gjuhës shqipe dhe Trajnimi për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të Qendrës për zhvillimin të RPJP për transparencë duke përmirësuar sistemin e komunikimit përmes rrjeteve sociale, nuk kanë ndikim negativ mbi ambientin jetësor.

Gjatë realizimit të projekteve rajonale, masat për realizim përfshijnë përmirësime në infrastrukturën komunale, gjatë kryerjes së punëve janë respektuar të gjitha standardet dhe masat për shmangien e ndikimeve negative në ambientin jetësor sipas Ligjit për ndërtim dhe të gjitha rregulloreve për organizimin e ndërtimit.

Me realizimin e projektit “Rikonstruksioni dhe pajisja e qendrës bashkëkohore për terapi fizikale në spitalin Shën. Erazmo”, janë shfrytëzuar burimet e rinovueseve të energjisë për ngrohjen e ujit dhe ambientet tek pishina. Gjithashtu, punimet ndërtimore nuk kanë ndikim negativ në mjedis, dhe janë respektuar të gjitha standardet dhe masat për shmangien e ndikimeve mjedisore sipas Ligjit për ndërtim dhe të gjitha rregulloreve për organizimin e ndërtimit.

Me projektin rajonal “Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe kontrolli energjetik për EE të objekteve publike”, janë bërë 11 kontrole energjetike me raporte dhe janë përgatitur projekte teknike me masa efikase energjetike për 12 objekte publike në rajonin Jugperëndimor. Të gjitha këto dokumente kanë për qëllim mbrojtjen e ambientit sepse propozojnë masa efikase energjetike dhe sisteme ngrohjeje për ndërtesat nga burimet e rinovuese të energjisë.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti mbrojtja dhe avancimi i ambientit jetësor gjatë zbatimit të projekteve të veçanta ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt/ aktivitete	Komponenti për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	Indikator/e
1.	Ndërtimi i rrugëve deri tek tokat bujqësore në RPJP	Pastrimi i terrenit, rremin, tamponimi me gurë të bluar natyror	Kualiteti i tokës, ajrit dhe ujit, nuk ka të dhëna nga matjet
2.	Biznes qendra	Shkresa, takime online, mentorim online	Kualiteti i tokës, ajrit dhe ujit, nuk ka të dhëna nga matjet
3.	Rekonstruksioni dhe vendosja e pajisjeve në qendrën bashkëkohore për fizio terapi në spitalin Shën. Erazmo	Veprimtari ndërtimore, instalim termo – teknik, instalim elektrik në pajtueshmëri me masat dhe standardet për tejkalimin e ndikimit negativ mbi ambientin jetësor	Kualiteti i tokës, ajrit dhe ujit, nuk ka të dhëna nga matjet
4.	Përgatitja e dokumentacionit teknik për kontroll energjetik dhe EE në objektet publike	Kontrolle energjetike me matjen e të gjitha parametrave, përgatitja e raporteve, përgatitja e dokumentacionit teknik	Kualiteti i tokës, ajrit dhe ujit, nuk ka të dhëna nga matjet
5.	Forumet rajonale	Nuk ka komponent për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	/
6.	Përkthimi i Programit për zhvillim të RPJP në gjuhën shqipe	Nuk ka komponent për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	/

7.	Trajnim për transparencë dhe përmirësimin e sistemit të komunikimit përmes rrjeteve sociale	Nuk ka komponent për mbrojtjen dhe avancimin e ambientit jetësor	/
----	---	--	---

## 7. Kontributi kah digjitalizimi në realizimin e Programit

Në këtë pjesë është prezantuar vlerësimi i përgjithshëm dhe të dhënat përmbledhëse për progresin e arritur dhe rezultatet e arritura në pjesën e digjitalizimit në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Shumica e aktiviteteve të Biznes Qendrës u realizuan Online, siç janë info sesionet, mentorimi dhe kapet e inovacionit. Gjithashtu publikimet në FB për mundësit e Sektorit të biznesit janë pjesë e shërbimeve digjitale.

Forumet rajonale, përkthimi i Programit në gjuhën shqipe dhe trajnimi për fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të Qendrës për zhvillimin të RPJP për transparencë duke përmirësuar sistemin e komunikimit përmes rrjeteve sociale, kanë komponent të digjitalizimit. Komunikimi me pjesëmarrësit në forumet rajonale u realizua përmes rrugës elektronike. Programi i përkthyer në gjuhën shqipe në formë digjitale u publikua në WEB faqen e qendrës. Trajnimi në vetvete jep mundësi përmes rrjeteve sociale dhe rrugës digjitale të shpërndahen informacione deri tek të gjithë palët e interesuara.

Në pjesën e projektit për Rekonstruksionit dhe vendosjen e pajisjeve në qendrën për terapi fizikale në spitalin Shën. Erazmo, pjesa më e madhe e proceseve me menaxhimin e pajisjeve të pishën janë të digjitalizua ra dhe automatike. Kjo i referohet shkallës për të arritur temperaturën e ujit, që është e nevojshme për funksionimin e pishinës së vogël dhe të madhe dhe nevojave për klorim dhe fluorizim të ujit.

Raportet nga kontrolli energjetik dhe përgatitja e dokumentacionit teknik me masa të efikasitetit energjetik për objektet publike janë përgatitur përveç formës së printuar dhe në formë digjitale.

Krahas vlerësimit të përgjithshëm për progresin e arritur në këtë drejtim, në tabelën më poshtë është dhënë përshkrim i shkurtër dhe i saktë se si është arritur saktësisht komponenti i digjitalizimit gjatë zbatimit të projekteve të veçanta ku bartëse është Qendra për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor.

Nr. rend	Projekt/ aktivitet	Komponenti i digjitalizimit	Indikator/e
1.	Ndërtimi i rrugëve deri tek tokat bujqësore në RPJP	Nuk ka komponent për digjitalizim	Nuk ka të dhëna
2.	Biznes qendra	Takime informative online, mentorimi, kamp inovacion (Google Meet, Zoom), publikime dhe shpërndarje në FB	4 sesione informative online për thirrjet nga FIZHT 12 ndërmarrje të mentoruara online për thirrjet e FIZHT Pjesëmarrje në 40 takime online Pjesëmarrje në 2 kampe inovative online 504 publikime në FB, 1750 mbështetës
3.	Rekonstruksioni dhe vendosja e pajisjeve	Rregullimi automatik i temperaturës së ujit, niveli i ujitë, klorimi dhe fluorizimi	Temperatura e ujit në mënyrë permanente është në lartësinë normale prej 32 C

	në qendrën bashkëkohore për fizio terapi në spitalin Shën. Erazmo		
4.	Përgatitja e dokumentacionit teknik për kontroll energjetik dhe EE në objektet publike	Raportet nga kontrollet energjetike të kryera në formë digjitale, dokumentacion teknik për objektet publike nën formë digjitale	11 raporte të kontrolleve EE 12 projekte teknike
5	Forumet rajonale	Komunikimi me pjesëmarrësit përmes postës elektronike	Ftesa dhe materiale të dorëzuara deri tek 80 përfaqësuesit nga rajonit
6	Përkthimi i Programit për zhvillim të RPJP në gjuhën shqipe	Formati digjital nga Programi i përkthyer që është i aksesueshëm nga WEB faqen e Qendrës	Programit i përkthyer në formë digjitale për WEB faqen
7	Trajnim për transparencë dhe përmirësimin e sistemit të komunikimit përmes rrjeteve sociale	Komunikimi në rrjetet sociale në rrugë digjitale	Publikimi i informacione në rrjetet sociale

#### 8. Raporti për punën financiar të Qendrës për zhvillim të rajonit planor

Në raportin financiar janë paraqitur të dhënat nga dy kontot e Qendrës për zhvillim, e cila njëra është bazike dhe njëra nën konto e cila është hapur për projektin e donatorit.

Në periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021 janë realizuar të ardhura në vlerë të përgjithshme prej 49.943.700 denarë, prej të cilave 41.208.561 denarë në konton bazike të Qendrës, ndërsa nën kontoja për projektin e donatorit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv“, në shumën prej 8.735.139 denarë. Realizimi procentual i të ardhurave është 45,93 % nga të ardhurat e parapara në Planin financiar për vitin 2021.

Në vitin 2021 janë realizuar shpenzime në shumën totale prej 25.529.084 denarë, prej të cilave në konton bazë 16.793.945 denarë, ndërsa nga nën kontoja e donatorit 8.735.139 denarë. Shpenzimet kapitale gjegjësisht aktivitetet e projektit në kuadër të projekteve rajonale janë siguruar në vitin 2020 dhe 2021 nga buxheti dhe burimet nga donatorët, janë harxhuar 20.429.745 denarë ose 80.02% nga shpenzimet e përgjithshme për vitin 2021.

Në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet, buxheteve dhe shfrytëzuesve të buxhetit në tërësi është zbatuar principi i pajtueshmërisë të obligimeve të marra dhe pagimi i të njëjtave gjatë vitit buxhetor aktual, ashtu që Qendra nuk ka obligime të bartura në vitin 2022. Në pajtueshmëri me evidencën e kontabilitetit, kërkesat e përgjithshme në datën 31.12.2021 janë 14.279.163 denarë.

Në periudhën e raportimit Qendra për zhvillim përgatiti dhe realizoi 7 furnizime publike. Nga të cilat 3 furnizime u realizuan përmes Sistemit elektronik për furnizime publike në pajtueshmëri me Ligjin për furnizime publike, ndërsa 4 furnizime publike u realizuan në pajtueshmëri me Rregulloren e donatorit për realizimin e pjesëve të veçanta të projektit „Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv“, i financuar nga Agjencioni Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria për vetëqeverisje lokale.

Raporti i përgjithshëm për punën financiare, i cili është pjesë përbërëse nga Raporti Vjetor, në pajtueshmëri me nenin 32 paragrafi 2 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, është dorëzuar si Aneks në fund të Raporti Vjetor.

## 9. Organizimi dhe menaxhimi

Të punësuarit e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor i kryejnë punët që janë në kompetenca të Qendrës dhe bëjnë punë profesionale për Këshillin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Gjatë vitit 2021 në Qendër ishin të punësuar 6 persona, prej të cilëve Drejtori, 3 Koordinator rajonal, Administratori dhe Koordinator për Biznes Qendrën. Nga numëri i përgjithshëm të personave të angazhuar në Qendër 4 janë femra dhe 2 janë meshkuj.

Të gjithë të punësuarit në Qendër janë me arsim të lartë. Drejtori i Qendrës është elektro inxhinier i diplomuar dhe Magjistër për zhvillim të barabartë lokal dhe rajonal, dhe është me marrëveshje për afat të caktuar kohor prej 4 viteve.

Koordinatorët janë: njëri është politikolog i diplomuar, një ekonomistë dhe një është i diplomuar në administrimin e biznesit dhe është magjistër në shkencat politike, dhe janë me marrëveshje me afat të papërcaktuar. Administratori është jurist i diplomuar dhe është me marrëveshje në afat të pa caktuar kohor. Koordinator i Biznes Qendrës ka diplomuar në Fakultetin Filologjik në Shkup dhe ka kryer magjistrimin për të drejtat e njeriut, është angazhuar për periudhën 9 mujore ( janar – shtator 2021) në pajtueshmëri me Marrëveshjen për përkrahje të Biznes Qendrës.

Gjatë periudhës së raportimit të punësuarit e Qendrës kanë marr pjesë në disa trajnime të cilat janë të rëndësishme për punën e Qendrës. I gjithë ekipi i Qendrës e ndoqi trajnimit për shfrytëzimin e MSI (Sistemi i Monitorimit të Informacionit) të Byros për zhvillim rajonal përmes të cilit në periudhën pasuese do të aplikohet Projekt aplikacione online. Tre të punësuarit e ndoqën trajnimin online në Byron për furnizimi publike në temën “E-tregu për furnizime me vlerë të vogël për organin kontraktues” i cili është me rëndësi të madhe për realizimin e furnizimeve publike në ESFP. Dy të punësuarit ndoqën trajnim për transparencë përmes përmirësimit të sistemit të komunikimit përmes rrjeteve sociale, dhe të njëjtën e mbajtën në Shqipëri. Një nga të punësuarit e ndoqi trajnimin online për portalet elektronike të Agjencionit për mbrojtje e të drejtës për qasje deti tek informacionet me karakter publik.

Këshilli për Zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor në seancën e mbajtur në dhjetor 2021 ka miratuar Vendim për organizimin e shërbimit profesional të Qendrës për zhvillimin të rajonit planor Jugperëndimor. Ky dokument është i harmonizuar me Ligjin e ri për ZHBR, Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me punën e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Për të punuar në mënyrë më efikase dhe për të arritur një shkallë më të lartë të realizimit të Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, me dokumentin e përmendur parasheh që Qendra për zhvillim Zhvillimore të organizohet në tre departamente në të cilat duhet të angazhohet staf profesional shtesë. Plotësimi i departamenteve me staf të përshtatshëm do të duhet të realizohet në faza për një periudhë më të gjatë kohore në përputhje me burimet financiare të siguruara. Prej këtu dhe në faza, me rritjen e punës do të duhet të punësohen ekspertë në të tre departamentet.

Këshilli për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor mbajti 6 seanca gjatë vitit 2021. Nga ana e Këshillit për zhvillim u shqyrtuan dhe u miratuan Raporti vjetor për realizimin e programit për zhvillim të RPJP në vitin 2020, Raporti vjetor për punën e Qendrës për vitin 2020, Raporti vjetor financiar dhe llogaria vjetore për 2020, Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor 2021-2026 (me pajtueshmëri të më parshme me Këshillin për zhvillim të barabartë rajonal në RMV), plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të RPJP për vitin 2021, Rregullore e re për punë të Këshillit për ZHBR, Vendimi për zgjedhjen e drejtorit të Qendrës për zhvillim të RPJP, Listën e projekteve prioritare për projekte rajonale, Vendim për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit për zhvillim në RPJP, Vendim për organizim të administratës profesionale në Qendrën për zhvillim të RPJP, Plani financiar për vitin 2022. Gjithashtu u soll Vendimi për realizimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin për zhvillim të RPJP nga sektori jo qeveritar dhe nga Sektori i biznesit. Përveç kësaj, mbajti takimin konstituiv Këshilli për mbrojtje sociale në rajonin planor Jugperëndimor, u soll Rregullore për punën e tij dhe u zgjodh Kryetar.

## 10. Propozime dhe sugjerime deri tek palët kyçe për politikat të zhvillimit të barabartë rajonal

Në këtë pjesë janë paraqitur propozimet dhe sugjerime konkrete për përmirësimin dhe avancimin e zbatimit të Programit të zhvillimit rajonal. Propozimet dhe sugjerimet dalin nga përvojat e Qendrave në përgatitjen e aplikacioneve dhe kriteret e aplikimit, zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe vlerësimin e projekteve dhe kanë të bëjnë me përmirësimin dhe avancimin e punës në proceset e dhëna.

Propozime dhe sugjerime për Këshillin për zhvillim të barabartë rajonal

Këshilli për zhvillim të barabartë rajonal të RMV të takohet më shumë herë gjatë vitit me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve. Vendimet me listat e propozuara për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve planore, të merren në fillim të vitit dhe të përcillen për miratim në Qeverinë e RMV-të. Në këtë mënyrë Qendrat për Zhvillim të rajoneve planore do të mund të fillojnë me kohë me realizimin e projekteve rajonale dhe të realizohen me sukses dhe në mënyrë cilësore aktivitetet e projektit brenda afateve të përcaktuara.

Propozime dhe sugjerime deri tek Ministria për vetëqeverisje lokale

Projektet për zhvillimin të rajoneve planore për vitin 2021 janë dorëzuar nga Qendrat për zhvillimin e rajoneve planore në Byronë për zhvillim rajonal në përputhje me afatin ligjor të parashikuar me ligjin e vjetër, deri më 15 dhjetor të vitit aktual për vitin e ardhshëm. Megjithatë, nga 5 shkurt 2021 hyn në fuqi Ligji i ri, i cili parashikon që projektet për zhvillimin e rajoneve planore të dorëzohen në Byronë për zhvillim rajonal jo më vonë se 31 janari i vitit aktual. Në pjesën e dispozitave kalimtare dhe përfundimtare, në Ligjin e ri për zhvillimin e barabartë rajonal, në asnjë nen nuk ka dispozitë të shkruar që nenet e ligjit të ri që kanë të bëjnë me paraqitjen, financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve rajonale do të fillojnë nga 2022, d.m.th projektet tashmë të aplikuara sipas ligjit të vjetër mund të realizohen në vitin 2021. Ky është një lëshim i madh që krijoj boshllëqe ligjore dhe kohore mes dy ligjeve. Por, nga ana tjetër në pajtueshmëri me nenin 52 paragrafi 4 nga Kushtetuta e RMV projektet e dorëzuara për vitin 2021 duhet të implementohen sipas Ligjit të vjetër. Në vend që të veprohet sipas Kushtetutës së RMV dhe ligjeve, u kalua në ndryshimin e Programit për zhvillim rajonal të BZHR e cila nga program një vjeçar u bë dy vjeçare. Edhe kjo nuk ishte e mjaftueshme dhe u iniciua ndryshimi i Ligji për ZHBR , për të cilin u prit shumë gjatë për tu votuar në Kuvendin e RMV. Nga Qendrat për zhvillim u kërkua që të tërhiqen projekt aplikacionet të dorëzuara sipas ligjit të vjetër dhe të përgatiten dhe të dorëzohen aplikacione të reja në fillim të gushtit të 2021. Projektet u vlerësuan në gusht nga ana e Komisionit për vlerësim, por për marrjen e Vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiar nga ana e Qeveris duhesh te të pritët që të mbaronin zgjedhjet lokale. Me këtë u shty realizimi i projekteve rajonale për një vit dhe me këtë mbetën edhe mjetet për shpenzime operative për funksionimin e Qendrave. Për të gjithë këto që u deklarua i rekomandohet Ministrisë të respektoj Kushtetutën dhe Ligjet e RMV-të.

Gjatë përgatitjes së Ligjit të ri për zhvillim të barabartë rajonal, Qendrat për zhvillim të rajoneve planore absolutisht nuk ishin të përfshira dhe të konsultuara. Edhe pas insistimit që të dorëzohet versioni punues i ligjit të ri, Qendrat për herë të parë mund ta shihnin ligjin në WEB faqen e Kuvendit të RMV i cili u vendua si material pune. E njëjta ndodhi edhe gjatë përgatitjes të disa rregulloreve siç është Rregullorja për përgatitjen e dokumenteve planore, Rregullorja për formën e Raportit vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajoneve planore e të tjera. Nga këtu, i rekomandohet Ministrisë që të jetë transparente dhe ti zbatoj principet e pjesëmarrjes , me atë që ti konsultoj Qendrat për zhvillim të rajoneve planore, për zgjedhjet ligjore dhe nën akteve ligjore me të cilat janë formuar dhe funksionojnë.

Në kuadër të Ministrisë për vetëqeverisje lokale ekziston Sektori për zhvillim rajonal, i cili sipas rregullave duhet të ketë komunikim direkt me Qendrat për zhvillim të rajoneve planore. Gjatë viteve të fundit Sektori për zhvillim rajonal absolutisht nuk kishte komunikim me Qendrat dhe as nuk mund të shoh që funksionojnë. Roli i saj është marr prej Njësi projektuese për implementimin e projektit për Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv. Rekomandojmë edhe sektori dhe njësia e projektit të punojnë në suaza të kompetencave të tyre.



Propozime dhe sugjerime deri tek Byroja për zhvillim rajonal

Me Byron për zhvillim rajonal Qendrat kanë komunikim dhe bashkëpunim të mirë. Rekomandojmë që të vazhdoj komunikimi dhe bashkëpunimi i rregullt dhe të thellohet me qëllim që të arrihen rezultate më të mira.

Gjithashtu, Byros i rekomandojmë që mos prish marrëveshje të njëanshme për realizimin e projekteve, pa pasur asnjë bazë ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjeve të nënshkruara.

Propozime dhe sugjerime deri tek ministrinë tjera në drejtim për realizimin e Programeve të resorëve të veçanta

Ministrive të tjera u rekomandojmë që të jenë më aktive në Këshillin për zhvillim të barabartë rajonal në RMV. Gjithashtu, rekomandojmë gjatë ndarjes së mjeteve për financimin e projekteve të dimensionojnë në pajtueshmëri me shkallën e zhvillimit të rajoneve planore. Të gjithë ministrinë tjera tu japin mundësi Qendrave për zhvillim të rajoneve planore që të mund të aplikojnë në thirrjet për financimin e projekteve.

Propozime dhe sugjerime deri tek Këshillat e Komunave të rajonit planor

Pas zgjedhjeve lokale që u mbajtën në tetor të vitit 2021, Këshillat e Komunave kanë përbërje të re. Rekomandojmë takime me këshilltarët me çka do të prezantonim politikat e zhvillimit rajonal, mundësit dhe aktivitetet të cilat i realizojnë Qendrat për zhvillim. Me këtë, njohja më së afërmi me këshilltarët do të nxisë bashkëpunimin më të mirë dhe shkëmbimin e ideve për zgjedhjen e problemeve të komunave dhe bashkimin e më shumë Komuna nga rajoni planor Jugperëndimor përmes projekteve rajonale.

## II. PJESA TABELARE E RAPORTIT VJETOR

Pjesa tabelare e raporti vjetor i përmban përbërjen e më poshtme:

### A. Pasqyrim tabelar për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve në funksion të realizimit të Programit për zhvillim të rajonit, ku bartëse është Qendra për zhvillim të rajonit planor

Këtu përfshihen të gjitha projektet, pa marrë parasysh burimet dhe programet e financimit, ku bartës është Qendra për Zhvillimin e rajonit planor: nga Programi për zhvillim rajonal të MVL dhe BZHR; nga buxhetet e Komunave të rajonit; Programi për subvencione kapitale për zhvillimin të rajoneve planore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural të MBPU-të; Programi për Mbështetjen Financiare për Zhvillimin Rural AFMZHR; programi APPRSM; programet e BE-së; Programet e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje; Programe nga burime ndërkombëtare financimi.

**B. Pasqyrim tabelar për realizimin e të gjitha projekteve gjatë vitit raportues në funksionin për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit, ku bartëse është Qendra për zhvillim të rajonit planor**

Këtu përfshihen të gjitha projektet e për investimet publike në rajon, qofshin ata buxhetore ose jashtë buxhetit, përkatësisht, përveç ministrive të tjera dhe komunat, këtu janë edhe projektet e ndërmarrjeve publike, fondet dhe shoqëritë aksionare me pronësi dominonte shtetërore. Të dhënat për këtë pasqyrë tabelare Qendra i marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes kontakteve na aktorët e përmendur, si dhe nga Sistemi elektronik për koordinim dhe planifikimi, realizimi, monitorimi dhe vlerësimi i politikave për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

**C. Pasqyrim tabelar për realizimin e të gjithë investimeve private në rajonin planor gjatë vitit raportues**

Të dhënat për këtë pasqyrë tabelare Qendrat i kanë marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes kontakteve me subjektet afariste në rajonin planor, nga odat ekonomike rajonale, si dhe nga aktivitetet e Biznes Qendrës.

**D. Pasqyrim tablera për numrin dhe përmbajtjen e aktiviteteve të realizuara për sigurimin e transparencës në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor gjatë vitit raportues**

Të dhënat për këtë pasqyrë tabelare Qendrat i kanë marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke menaxhuar me projektet ku janë bartës në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor.

**A. PASQYRIMI TABELAR PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE NGA PROJEKTET NË VITIN RAPORTUES NË FUNKSION PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR PËR VITIN 2021-2026, KU BARTËS ËSHTË QENDRA PËR ZHVILLIM E RAJONIT PLANOR**

(Tabela është përshtatur në pajtueshmëri me numrin e qëllimeve strategjike të definuara, numrin e prioriteteve të definuara në kuadër të qëllimeve strategjike, numri i masave të definuara në kuadër të çdo prioriteti të definuar dhe numri i aktiviteteve të projektit për çdo masë të definuar, në pajtueshmëri me Programin për zhvillim të rajonit planor 2021-2026 të përcaktuar)

Qëllimi strategjik 1 – Avancimi i ekonomisë dhe paritetin gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive krahasimore të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji të reja, njohuri dhe inovacion, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësi dhe zhvillim rural.								
MASA	PROJEKT/ AKTIVITET	BURIMET FINANCIARE	PROGRAMI	VLERA E PËRGJITHSHME E PROJEKTIT (total)	MJETE TË REALIZUARA	PARTNER NË IMPLEMENTIM	SHFRYTËZUES	INDIKATOR/Ë
Prioriteti 1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale								
1.1.1	Nxitja e shpirtit sipërmarrës tek të rinjtë e posaçërisht tek gratë përmes trajnimeve dhe mbështetjes TIK dhe start-up bizneseve të reja	Nuk ka aktivitete të realizuara						
	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.1.2	Krijimi i një rrjeti informativ për							

	zhvillim të inovacioneve në rajon	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.1.3	Nxitja e unioneve dhe formimi i klasterave	Nuk ka aktivitete të realizuara							
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes qendra/ programi i vauçerëve për ngritjen e kapacitetit tek biznes sektori	MVL/ SDC/ Projekti ZHBQIR –faza e 1 për realizim	Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv	304.000	266.567	FIZHT	Ndërmarrje nga RPJP	12 ndërmarrje morën ndihmë me mentor për të aplikuar në FIZHT
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM	Biznes qendra/ publikimi i listës për mundësit e burimeve të financimit nga qeveria dhe burimeve të tjera për biznes sektorin	MVL/ SDC/ Projekti ZHBQIR –faza e 1 për realizim	Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv	46.268	46.268	Komuna, biznes sektori në RPJP	Firma individuale të interesuara nga RPJP	12 publikime nga institucionet qeveritare dhe 26 institucione nga sektori civil dhe privat
1.1.5	Brendimi i produkteve dhe shërbimeve që janë të njohura për rajonin.	Nuk ka aktivitete të realizuara							
<b>Prioriteti 1.2 Fuqizimi dhe modernizimi i sektorit të NVM-ve</b>									
1.2.1	Nxitja e iniciativave për ndryshime strukturore tek sektori i NVM në rajon	Nuk ka aktivitete të realizuara							

